

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “FENIX GROUP” SHPK

Ortakët themelues të Shoqërisë :

1. Meto Hetaj ,me atësi Bashkim, dtl.25/03/1994 lindur në Shkoder dhe me banim ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me numer personal ID J40325109S

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

mbledhur në Tiranë sot më datë 12/01/2018,

#### VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

#### NENI 1. Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj “**FENIX GROUP**” SHPK.

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

#### NENI 2 Forma juridike

2.1 Shoqëria tregtare “**FENIX GROUP**” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeterjuridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

#### NENI 3 Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Njesia Bashkiake Nr 9 Rruga "Sheshi Ferdenc Nopcka" Nd.6,H.3,Ap.32

**3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.**

**3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.**

**NENI 4**  
**Vula e shoqërisë**

**4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.**

**4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;**

**NENI 5**  
**Objekti i Veprimtarisë**

- **Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:**

Te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj veprimtarie nepermjet telefonit per llogari te vet apo te te treteve me seli ne Shqiperi apo cdo vend tjeter qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise. duke respektuar ligjin ne fuqi: te kryeje aktivitete nepenrijet telefonit te cdo lloj I per llogari te vet apo te te treteve. telemarketing, sekretari telefonike. shitje nepermjet telefonit. sondazhe, mesazhe promocionale dhe cdo lloj tjeter aktiviteti te lidhur me te. ku persa permendur me siper nuk mund te jete saktesisht apo e kufizuar; te bleje e te shese ose te jape me qira. ne perdonim, ne uzufruk. ose ne shftylezim pasuri te luajtshme e pasuri te paluajtshme te regjistruala ne regjistrat publike. Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te ngjashem apo te afert me te vetin. Shoqeria mund te kete pjesemarrje ne formen e mbajtjes se aksioneve/kuotave apo interesave te tjera ne shoqeri tregtare apo ndermarrje me objekt veprimtarie te cfaredo lloji, ashtu sikur se do te ofroje dhe jape garanci te gjitha formave llore per sigurimin e 2 permbushjes se detyrimeve te te treteve. gjithashtu mund te kneje te gjitha veprimet e nevojshme te vendimmarres dhe administrimit te shoqerive apo ndermarrjeve ne te cilat menjese ne cilesine e ortakut apo aksionarit si dhe do te kryeje cdo veprimtari tjeter te natyres financiare e tregtare per permbushjen e objektit te veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Ligjin Shqiptar.

**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

**6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.**

**6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.**

**Neni 7**  
**Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat**



**7.1** Kapitali i rregjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100 (nje qinde) lekë.

1.Meto Hetaj, zotëron një kuote me vleren 100(njeqinde ) lek, që perfaqeson 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

**7.2** Ortakët, në bazë të kërkeshës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhe parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zoterojnë.

**7.3** Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

#### **NENI 8 Organet e Shoqërisë**

**8.1** Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

**8.2** Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### **NENI 9 Administratori**

**9.1** Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

**9.2** Administrator i Shoqërisë do të jete Meto Hetaj.

#### **NENI 10 Dispozita të fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

#### **NENI 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Tiranë.

*Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.*

*Ortaku nēnshkruan mē dēshirē dhe vullnet tē plotē aktin themelues tē shoqērisē.*

**ORTAKET THEMELUES**

Meto Hetaj

Meto Hetol A.